



LAVI – ndihmë viktimave

- Keni qenë viktimë e ndonjë dhune fizike, seksuale, ndonjë dhunë familjare agresioneve të ndryshme, kërcnimeve apo edhe viktimë ndonjë aksidenti rugore, ...?
- Keni mungesë që lidhet drejtëpërdrejtë me dhunën?
- I ndjeni ende efektet e traumave të mëparshme?
- Ende jetoni me frikë se ngjarje të ngjajshme mund të ju përsëriten?

Qendrat e Konsultimeve LAVI ju informojnë, ju përkrahin dhe ju ndihmojnë që të ballafaqoheni më lehtë me pasojat e dhunës. Konsultimet janë falas dhe mbeten të besueshme dhe anonime.

Do të mund të gjeni:

- dëgjim, përkrahje dhe këshilla;
- informata për të drejtat tuaja;
- shoqëruar për t'ju ndihmuar gjatë proceseve juridike dhe administrative;
- ndihmë materiale nëse ka nevojë;
- orientim tek partnerët e specializuar (mjekët, psikologët, avokatët, mund t'ju sigurohet vend strehim etj)

Qendrat e Konsultimeve LAVI bashkëpunojnë me shërbimet e përkthyesve.

Jeni një viktimë, çka duhet të bëni?

- shkoni në ndonjë vend të sigurtë dhe mundësishtë ruani dëshmit e përjetimit të dhunës.
- lajmërohuni në njërin prej numrave:
 - polici: 117
 - ndihma e shpejtë 144
- shkoni tek një mjek i besueshëm ose në ndonjë spital të afërt për të marrë ndihmën e nevojshme dhe një raport mjekësor;
- paraqiteni në njërin prej Qendrave për konsultim LAVI ose kërkoni nga ndonjë i besueshëm që të paraqitet për ju.

Për të kontaktuar Qendrat për Konsultime LAVI:

Valais Qendror: 027 607 31 00

Valais i Poshtëm: 027 607 31 00

Valais i Sipërm: 027 946 85 32